



Handwritten signature

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. ___ prot.

Tiranë, më 16. 3. 2018

5447/1
Lënda:

Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1628, datë 30.05.2013.

SHOQËRISË "AYEN AS ENERGY" SH.P.K

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers, Kulla 2, Kati 10, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM,**
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "Ayen As Energy" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1628, datë 30.05.2013, për mineral serpentinë, në objektin "Qafë Mollë", Mirditë, Qarku Lezhë.

Nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën nr.5934, datë 01.08.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5447, datë 02.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1628, datë 30.05.2013, për mineral serpentinë, në objektin "Qafë Mollë", Mirditë, Qarku Lezhë, për arsye se nuk është bërë pagesa e garancisë vjetore të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2014 dhe për vitin 2015, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Shkresa me propozimin e AKBN-së i është dërguar edhe shoqërisë tuaj, për dijeni, dhe pas këtij njoftimi ju keni bërë kërkesë në adresën e Institucionit tonë me nr.3, datë 02.08.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr.5384/1, datë 03.08.2017, duke kundërshtuar propozimin e mësipërm. Ju keni bërë argumentimin tuaj për arsyen për të cilën kundërshtoni këtë propozim. Në kërkesën tuaj shpreheni se keni respektuar Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 (i ndryshuar), dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, ku gjithashtu keni kërkuar, për mungesë tregu, ndërprerjen e përkohshme të punës.

Ligji, të cilit i referoheni në shkresën tuaj, nuk përcakton ndërprerje të përkohshme pune apo ulje prodhimi për mineralet e grupit ndërtimor, pra në bazën ligjore ekzistuese nuk parashikohet.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në gërmën "c", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1628, datë 30.05.2013, për mineral serpentinë në objektin "Qafë Mollë", Mirditë, Qarku Lezhë, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë të ditur se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1628, datë 30.05.2013, për mineral serpentinë, në objektin "Qafë Mollë", Mirditë, Qarku Lezhë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËS MINISTRI

EDIS ALIKO

